



**RAPORT MBI PROCESIN E HARTIMIT TË AKTIT FILLESTAR TË
PLANIT TË INTEGRITETIT 2023-2026**

Me datën 16.11.2022 është nxjerr Vendimi me numër 112/02-26240 përmes së cilit Kryetari i Komunës së Gjakovës ka formuar grupin punues për hartimin e planit të integritetit 2023-2026.

Në të njëjtën ditë ka filluar puna e grupit punës për hartimin e aktit fillestar i cili është i bazuar në formatin e rekomanduar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe në versionin e fundit të Planit të Integritetit të Komunës së Gjakovës 2020-2021.

Pas përfundimit të konsultimit të brendshëm të Draftit të Planit të Integritetit, Drafti me dt. 17.11.2022 është publikuar në web-faqen zyrtare të komunës bashkërisht me Njoftimin për Konsultim Publik ku dhe ka qëndruar për 1 muaj për konsultim. Gjatë kësaj periudhe asnjë koment apo sugjerim nuk është pranuar.

Me dt. 19.12.2022 në ora 10:00 është mbajtur takimi me qytetarët në sallën e Asamblesë, ku dhe kishim të pranishëm 10 pjesëmarrës, për të cilët grupi punues ka bërë prezantimin e Draftit të Planit dhe ka hapur diskutimin me pjesëmarrësit, nga të cilët ka pranuar konfirmimin e plotë të draftit pa ndonjë koment/sugjerim/rekomandim.

Për aq sa u tha me lartë, në cilësinë e kryesuesit të grupit punës ju dërgoj në kompetencën tuaj për procedura të mëtutjeshme Draft Planin e Integritetit 2023-2026.

Taulant Vokshi

Kryesues i Grupit Punues